

## THIRRJE PËR PROJEKT-IDE

### NISMA KOMUNITARE DHE AKTIVITETE RRJETËZIMI

për fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e komuniteteve të qëndrueshme ndaj  
ekstremizmit të dhunshëm

#SHQK

#PërKomunitetin

#### Konteksti i projektit

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri dhe në bashkërendim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, po zbaton projektin “Zgjerimi i rrjetit të Komuniteteve të Qëndrueshme në Shqipëri përmes modelit shumë-aktorial Shkolla Qendër Komunitare (SHQK)” në 16 bashki dhe shkolla të mesme të përgjithshme të vendit.

Projekti ka si qëllim zhvillimin e qasjes shumë-aktoriale SHQK përmes ndërtimit të një partneriteti strategjik ndërmjet institucioneve vendore – Shkollës – Bashkisë – Policisë, si dhe midis tyre dhe komunitetit të prindërve, nxënësve, të rinjve dhe organizatave të shoqërisë civile, për të krijuar komunitete të shëndetshme dhe të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Shkollat e përfshira në projekt janë: “Oso Kuka” **Shkodër** | “Arbëria” **Bulqizë** | “Halit Bërzeshta” **Prrenjas** | “Haxhi Qehaj” **Rrogozhinë** | “Arif Halil Sulaj” **Mamurras, Kurbini** | “Ali Aslani” **Kotë, Selenicë** | “Tomorr Sinani” **Cërrik** | “Zihni Magani” **Peqin** | “Dom Nikoll Kaçorri” **Durrës** | “Isa Boletini” **Vorë** | “Sadik Stavileci” **Kashar, Tiranë** | “Shote Galica” **Fushë-Krujë** | “Skënderbeu” **Krujë** | “16 Shtatori” **Shijak** | Shkolla Manëz, **Durrës** | “Ibrahim Rugova” **Kamëz**

Në kuadër të komponentit për fuqizimin e të rinjve dhe aktivizimin në komunitet, IDM hap thirrjen për projekt-ide për nisma komunitare dhe aktivitete rrjetëzimi në nivel vendor, në përshtatje me nevojat dhe problematikat konkrete të të rinjve dhe komunitetit.

#### Qëllimi i projekt-ideve:

- Të promovohet partneriteti mes institucioneve vendore – Shkollë-Bashki-Polici –dhe rritja e ndërveprimit midis këtyre institucioneve dhe të rinjve e komunitetit në tërësi.
- Të nxitet angazhimi i të rinjve dhe pjesëmarrja qytetare në proceset vendimmarrëse vendore.
- Të mbështetet aktivizimi i të rinjve në nivel vendor, përmes nismave në komunitet dhe vullnetarizmit.
- Të promovohet rrjetëzimi i të rinjve dhe shkollave që janë pjesë e projektit me shkolla të tjera të mesme të përgjithshme në vend.
- Të nxitet përfshirja e komunitetit dhe e prindërve në veprimtaritë e shkollës dhe aktiviteteve me të rinjtë.



### **Projekt idetë mund të zhvillohen në një nga dy format e mëposhtme:**

- Aktivitete në nivel vendor, të organizuara brenda komunitetit të shkollës, bashkisë, dhe/ose qytetit me përfshirjen e komunitetit të gjerë.
- Aktivitete rrjetëzimi ndërmjet dy apo më shumë shkollave në nivel ZVA-je, shkollave në qytete të ndryshme, dhe/apo bashkive me komunitetet përkatëse. Në këtë rast, shkollat/bashkitë që mbështeten nga IDM duhet të jenë organizatorët kryesorë të projekt idesë.

Në çdo rast, kohëzgjatja e ideve të propozuara duhet të jetë nga 1-4 muaj, Nëntor 2021 – Shkurt 2022.

### **TEMATIKA E PROJEKT-IDEVE:**

- Aktivizimi i të rinjve për të nxitur transparencën dhe konsultimin publik nga ana e bashkisë;
- Pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendimmarrëse vendore për të zhvilluar një qytetari aktive;
- Aktivitete ndërgjegjësimi ndaj fenomeneve negative në shoqëri – bullizmi, diskriminimi social, paragjykimet dhe gjuha e urrejtjes, dhuna dhe elementët e ekstremizmit të dhunshëm;
- Aktivitete sensibilizuese për sigurinë rrugore, kujdesin për jetën dhe menaxhimin e situatave problematike;
- Krijimi i grupeve vullnetare të të rinjve që adresojnë çështje të ndryshme sociale në komunitet;
- Aktivitete për promovojnë diversitetin, bashkëjetesën dhe harmoninë ndër-fetare;
- Aktivitete artistike, vizita dhe shkëmbime kulturore për të njohur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore;
- Aktivitete sportive dhe kampionate ndërmjet shkollave në nivel ZVA-je, të rinjve të komunitetit, përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe aktorëve të tjerë;
- Bashkëpunim midis shkollave dhe sektorit privat për të ndihmuar në zhvillimin profesional të të rinjve, përmes mentorimit dhe praktikave vullnetare të punësimit;

Aktivitetet duhet të bazohen në parimin e gjithëpërfshirjes së të rinjve, pa dallime sociale dhe ekonomike, duke marrë në konsideratë prirjet e veçanta të tyre.

Fondi në dispozicion: Varësisht idesë së propozuar, formatit të aktiviteteve dhe nivelit të përfshirjes së aktorëve vendorë, do të variojë dhe shuma e akorduar për çdo projekt ide.

### **KUSH MUND TË PARAQESË NJË PROJEKT-IDE:**

Kjo thirrje është e hapur për të gjithë aktorët vendorë të përfshirë në zbatimin e modelit shumë aktorial Shkolla Qendër Komunitare në 16 shkolla të mesme dhe bashki të përmendura më lart (në kuadër të projektit që zbaton IDM):



1. Shkolla e mesme e përgjithshme, përfshirë:
  - drejtuesit, mësuesit, oficerët e sigurisë dhe psikologët
  - qeveria e nxënësve në shkollë
  - bordi i prindërve të shkollës
2. Bashkia
3. Komisariati i policisë
4. Komunitetet fetare
5. Organizatat rinore / Organizatat me bazë komunitare në nivel lokal

#### **Procedurat e aplikimit:**

Të gjithë të interesuarit (listuar më sipër) mund të shprehin idetë e tyre duke plotësuar:

- Formularin e aplikimit; dhe
- Buxhetin e detajuar për aktivitetet (bashkëngjitur kësaj thirrjeje).

Dokumentet mbështetëse që duhet të shoqërojnë projekt idenë janë:

1. Në rastin e aplikantëve përfaqësues të institucioneve vendore:
  - Kopje e Kartës së Identitetit të drejtuesit të institucionit / individit që aplikon me projekt idenë;
  - CV e plotë në shqip.
2. Në rastin e aplikantëve persona juridikë (OJF):
  - Vendimi i regjistrimit në gjykatë (kopje);
  - Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje);
  - Regjistrimi (NIPT) në Zyrën e Taksave dhe Tatimeve (kopje);
  - Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës me të rinjtë.

Projekt idetë mund të dorëzohen në çdo moment, me plotësimin e procedurave të nevojshme për aplikimin. Aplikimi dorëzohet elektronikisht në adresën: [ghoxha@idmalbania.org](mailto:ghoxha@idmalbania.org).

**Vizibiliteti i nismave:** Zbatuesit e nismave, pavarësisht formës së aktivitetit, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të publikuar faktin që Ambasada e SHBA-së në Shqipëri është financuesi kryesor i nismave/projekt ideve, në kuadër të qasjes shumë aktoriale Shkolla Qendër Komunitare.

